



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KRYETARI

Nr. 268d/1 Prot.

Fier, më 25/03/2021

VENDIM

Nr. 2 datë 25/03/2021

Për caktimin e vendeve publike në territorin e Bashkisë Fier për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore , për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 3 pika 5, nenit 77 pika 1, nenit 78 pika 1 dhe 4, nenit 79 dhe nenit 88 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 **“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”** i ndryshuar, në mbështetje të nenit 24/2, pika 4 dhe 5 të Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 **“Për partitë Politike”** i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”**, në Ligjin nr.139/2015 **“Për vetëqeverisjen vendore”**, në zbatim të Udhëzimit Nr.6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KQZ) **“Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”**, në zbatim të nenit 9 të Vendimit të Komisionit Rregullator të K.Q.Z. nr.12 datë 30.12.2020 **“Per miratimin e rregullave për veprimtarinë e Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”**, në kuadër të zhvillimit të një fushate elektorale të rregullt e korrekte, në kuadër të respektimit dhe mbajtjes pastër të hapësirave publike të bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Fier,

VENDOSA:

- 1- Të caktoj vendet publike në territorin e Bashkisë Fier për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike, për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas listës bashkangjitur këtij vendimi.
- 2- Materiale propagandistike statike, janë të gjitha materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik, si në shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse, etj, në përputhje me listen e bashkangjitur këtij vendimi.
- 3- Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se **1 (një)** zyrë zgjedhore (elektorale) për lagje qyteti ose fshat. Subjektet zgjedhore janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Kryetarin e

Bashkisë Fier, për adresat e sakta të zyrave elektorale në territorin e Bashkisë Fier, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve.

- 4- Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera, lejohet vetëm në një distancë (*në një largësi*) prej deri **5 (pesë) metrash** nga zyra zgjedhore (*elektorale*) e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës dhe jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
- 5- Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të.....” (vijon emri i subjektit zgjedhor).
- 6- Ndalohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m.
- 7- Ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese me natyrë ndotëse (*përdorimi i bojrave të ndryshme ose spray paint për shkrimin e parullave elektorale në mure apo në vende publike, etj.*), si dhe përdorimi i materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë vendim, që përbëjnë dëmtim apo cënim të hapësirave apo investimeve publike, të cilat do të rikuperohen në gjendjen fillestare me kosto të vet partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.
- 8- Lidhur me materialet edukative , caktohen vendet publike me akses dhe hapësirë të bollshme për publikun për afishimin e materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor, të cilat i shërbejnë edukimit të zgjedhësve, lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor, për fushatën zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas listës bashkangjitur këtij vendimi;
- 9- Bashkia, nëpërmjet organeve të zbatimit të ligjit në varësi të saj, do të heq menjëherë të gjitha materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore, që janë afishuar në vende jashtë përcaktimeve të këtij vendimi dhe që janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimet/udhëzimet e KQZ-së.
- 10- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati Vendor Mbrojtjes Territorit (IVMT), Policia Bashkiake, Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit të Punëve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier, Kabineti i Kryetarit të Bashkisë.
- 11- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet public në faqen e internetit të Bashkisë .

Konc.: _____

Miratoi: _____

Afati i ruajtjes: _____

Nr.Kopjeve: _____

KRYETARI I BASHKISË
Armando SUBASHI



**LISTA E AMBIENTEVE PUBLIKE ME AKSES TË PLOTË DHE HAPËSIRË TË
BOLLSHME PËR PUBLIKUN
PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE EDUKATIVE ZGJEDHORE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

- Zyra me një ndalesë, Bashkia Fier;
- Kendet e njoftimeve pranë zyrave të Gjendjes Civile pranë Njësive Administrative 1;2;3;4;
- Kendet e njoftimeve në ambientet e Njësive Administrative , Bashkia Fier :
- Njësia Administrative Qëndër;
- Njësia Administrative Mbrostar –Ura
- Njësia Administrative Portëz
- Njësia Administrative Cakran
- Njësia Administrative Libofshë;
- Njësia Administrative Levan;
- Njësia Administrative Frakull;
- Njësia Administrative Topojë;
- Njësia Administrative Dërmënas;

Lista

**për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për
Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021**

- 1. Bill Board 16 copë me vendndodhje në Rrugën Ramiz Aranitasi dhe Bulevardi Jakov Xoxa Fier**